



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1922/4 prot.

Datë 21.10.2021

V E N D I M
Nr. 786/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2021, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1922 prot., datë 12.10.2021 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-05844-09-20-2021, me objekt: “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çatave të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9.953.982 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D – Plan” SHPK & “Aida Konstruksion” SHPK
Rruga “Jusuf Vrioni”, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol SHA
Selia Rruga Fier – Patos, Km 7
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit

të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.09.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05844-09-20-2021, me objekt: “*Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit", i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë*”, me fond limit 9.953.982 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se, autoriteti kontraktor në datë 07.10.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D – Plan” SHPK & “Aida Konstruksion” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin si më poshtë vijon:

1. *Nuk ka paraqitur formularin e deklarimit sipas shtojcës 8 të DST-së OE “AIDA CONSTRUCTION”.*

2. OE "6D – PLAN" ka deklaruar se ka paraqitur ofertë të pavarur kur në fakt është bashkim operatorësh, në kundërshtim me gjurmën "gj" të pikës 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit" të shtojcës 7 të DST-së.
3. Nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit të viteve 2018 dhe 2019 OE "AIDA CONSTRUCTION" në kundërshtim me pikën 2.2.1. të DST-së.
4. Nuk ka paraqitur akt-ekspertizën e ekspertit kontabël për bilancin e vitit 2018, 2019 & 2020 OE "6D – PLAN" në kundërshtim me pikën 2.2.1. të DST-së.
5. Nuk ka paraqitur kontratë individuale pune për Ing. E Ndërtimit Z. A. Kristo, OE "6D – PLAN", në kundërshtim me gjurmën "a" të pikës 2.3.3. të DST-së.
6. Nuk korrespondon Ing. Mekanik I paraqitur në dokumentacion me Ing. Mekanik të deklaruar në shtojcën 8 të DST-së.
7. Ka deklaruar në shtojcën nr. 8 vetëm 3 inxhinierë nga 5 të kërkuar në DST.
8. Nuk kanë dëshmi kualifikimi manovratorët E. Troksi dhe B. Petritaj, në kundërshtim me gjurmën "c" të pikës 2.3.3. të DST-së.
9. Nuk ka asnjë punonjës të pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit", në kundërshtim me gjurmën "d" të pikës 2.3.3. të DST-së.
10. Nuk ka paraqitur 2 punonjës që disponojnë certifikatë trajnimi "Për punime në lartësi", por vetëm 1, kjo në kundërshtim me gjurmën "f" të pikës 2.3.3. të DST-së.
11. Nuk ka paraqitur certifikatën PAS 99-2012 të vlefshme, ajo ka skaduar prej datës 26/08/2020, OE "AIDA CONSTRUCTION", në kundërshtim me gjurmën "a" të pikës 2.3.4. të DST-së.
12. Nuk ka paraqitur Licencë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) kodin III.2.B, OE "AIDA CONSTRUCTION" ShPK, në kundërshtim me gjurmën "b" të pikës 2.3.4. të DST-së.

II.3. Në datën 11.10.2021, është publikuar Njoftimi i anulimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dhe në datë 18.10.2021 është publikuar Njoftimi i anulimit në Buletinin Nr.151 datë 18 Tetor 2021, me arsyetimin se "Nuk u kualifikua asnjë ofertë për mungesë dokumentacion".

II.4. Në datën 12.10.2021, bashkimi i operatorëve ekonomikë "6D – Plan" SHPK & "Aida Konstruksion" SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1922/2 date 13.10.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "6D – Plan" SHPK & "Aida Konstruksion" SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Në datën 19.10.2021, bashkimi i operatorëve ekonomikë "6D – Plan" SHPK & "Aida Konstruksion" SHPK, me anë të shkresës Nr. 10/19 prot., datë 19.10.2021, protokolluar me

tonën me nr. 1922/3 prot., datë 19.10.2021, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik kërkesën për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05844-09-20-2021, me objekt: “*Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit" i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë*”, me fond limit 9.953.982 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “6D – Plan” SHPK & “Aida Konstruktion” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në datën 12.10.2021, në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05844-09-20-2021, me objekt: “*Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit" i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë*”, me fond limit 9.953.982 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 1922 prot., datë 12.10.2021 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018,

datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ në lidhje me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “6D – Plan” SHPK & “Aida Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-05844-09-20-2021, me objekt: “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9.953.982 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SHA.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “6D – Plan” SHPK & “Aida Konstruksion” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri